



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:092425

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05805207

C.nr.548/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore, me gjyqtarin individual Blerim Istrefi, në çështjen juridike kontestimore të paditëseve: K.S, S.K, A.M, E.G dhe H.V që të gjithë nga M..., të cilët sipas autorizimit e përfaqëson Leutrim Ademi avokat me seli në Mitrovicë, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës-D..K...A..., lidhur me çështjen kontestuese: Kompensimin e inflacionit në pagë dhe shujtave ushqimore, jashtë seancës, me datë 11.06.2024 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëseve K.S, S.K, A.M, E.G dhe H.V që të gjithë nga M..., ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës-D..K...A..., që paditëseve që paditëseve në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës për periudhën kohore 12.03.2020 e deri me 31.12.2020 si dhe në emër të kompensimi te shtesave ne page-inflacionit për periudhën nga data 20.04.2019 e deri me 30.12.2020, ti kompensoj si ne vijim:

- Paditëses K.S, në emër të shujtës ushqimore(nga 2 euro në ditë), për 64 dite të prezencës në punë shumën prej 128.00€, ndërsa në emër të inflacionit në pagë shumën prej 115.76€;
- Paditëses S.K, në emër të shujtës ushqimore(nga 2 euro në ditë) për 73 ditë të prezencës në punë shumën prej 146.00€), ndërsa në emër të inflacionit në pagë shumën prej 120.07€;
- Paditëses A.M, në emër të shujtës ushqimore(ne shumën prej 2 euro) për 71 ditë të prezencës në punë shumën prej 142.00€, ndërsa në emër të inflacionit në pagë shumën prej 120.03 €;
- Paditësit E.G, në emër të shujtës ushqimore(nga 2 euro në ditë), për 74 dite të prezencës në punë shumën prej 148.00, ndërsa në emër të inflacionit në pagë shumën prej 120.03 €; dhe
- Paditëses H.V, në emër të shujtës ushqimore(nga 2 euro në ditë) për 74 ditë të prezencës në punë shumën prej 146.00€, ndërsa në emër të inflacionit në pagë shumën prej 126.29 €;

Për secilin paditës veç e veç me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga data 17.05.2021, datë e paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto (borxhin

kryesor dhe kamatën) në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Mitrovicës – D..K...A... që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 332.00 €, të gjitha këto ti përmbush në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre, pranë kësaj gjykate me datë 17.05.2021, kanë parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi shujtës ushqimore dhe kompensimin i shkallës së inflacionit të pa paguar në pagë. Në padi dhe në zgjerimin e të njëjtës kanë theksuar se paditësit janë të punësuar pranë të paditurës dhe se paditësve ju takon shujta që për periudhën kohore 12.03.2020 e deri 31.12.2020 shumat si në dispozitiv si dhe për të gjithë paditësit inflacioni për periudhën kohore 20.04.2019 e deri me 30.12.2020, shumat si në dispozitiv, të gjitha me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga data 17.05.2021 datë e paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto (borxhin kryesor dhe kamatën) në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë 312.00 € për padi dhe 20 € për taks gjyqësore.

Gjykata, pas shqyrtimit paraprakë të padisë ka nxjerr aktvendim për përgjigje në padi C.nr.548/2021 të datës 17.04.2024, duke e paralajmëruar edhe me pasojat procedurale se nëse nuk parqet përgjigje në padi në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit të lartpërmendur, gjykata do të merr aktgjykim në bazë të pa dëgjueshmërisë / mosbindjes.

E paditura në përgjigjen në padi të paraqitur me datën 20.04.2024 ka theksuar se pohon padinë dhe kërkesë padinë në tërësi pasi që të njëjtë kanë bashkangjitur prova me anë të cilave dëshmojnë ditët e pranisë në punë si dhe lisën e pagës për të vërtetuar shumat e kompensimit të shtesave në inflacion.

Prandaj gjykata në kuptim të nenit 148 par. 1 të LPK –se me të cilin përcaktohet se: ” Në qoftë se i padituri deri në përfundim të shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata jep pa shqyrtim të mëtejme, aktgjykim me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykim në baze të pohimit)” dhe gjykata vendosi pa shqyrtim të mëtejme si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi në pike I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, e në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debitorin, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë, e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë datë 17.05.21.

Gjykata vendosi si në piken III të dispozitivit, në kuptim të nenit 452 të LPK-së ashtu që e detyrohet e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padisë shumen në lartësi prej 312.00€ - sipas tarifës së OAK, si dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 20.00 €.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2021:092425
Datë: 11.06.2024
Numri i dokumentit: 05805207

GJYKATA THEMELORE NË MITROIVCË
Departamenti i përgjithshmen-Divizioni civil
C.nr.548/2021, datë 11.06.2024

Gjyqtari
Blerim Istrefi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.